

7. KUPTIMI I MJETEVE KRYESORE –AKTIVEVE (ASETEVE) AFAGJATA

Evidenca kontabël, në evidencën e sajë të përgjithshme, ka të bëjë me mjetet, burimet e mjeteve, të ardhurat dhe të dalat, si dhe rezultatin financiar nga puna e rregullt dhe e jashtëzakonshme, njëherit i ndjek ndryshimet që kanë të bëjnë me mjetet kryesore (themelore) në kuadër të një subjekti ekonomik.

Mjet apo resurs ekonomik i një subjekti ekonomik konsiderohet ajo pasuri e cila i plotëson kushtet siç janë:

- a). është nën kontrollën e subjektit ekonomik si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën; dhe
- b). nga ato, sipas SNK 38, priten që në subjektin ekonomik të hyjnë përfitime të ardhshme ekonomike.

Me aktivet e subjektit ekonomik kuptojmë të gjitha të mirat materiale të shprehura në vlerë, përmes të cilave zotëron një subjekt ekonomik. Për nevojat e ndryshme subjektet ekonomike posedojnë aktive të llojeve të ndryshme.




Në teorinë kontabël ka nocione dhe sqarime të shumta se çka në fakt paraqesin mjetet apo pasuria afatgjate. Sipas disa autorëve, asetete (mjete) afatgjate paraqesin pasurinë kryesore prodhuese për shumicën e subjekteve prodhuese ekonomike të shprehura në vlerë.

Shprehja mjetet kryesore (asete apo aktive afatgjate) shfrytëzohet për përshkrimin e mjeteve afatgjate që furnizohen për përdorim në afarizmin e subjektit ekonomik dhe nuk e ka për qëllim shitjen e mëtejshme tek blerësit.

Mjete kryesore janë të gjitha ato mjete që i sigurojnë përfitime subjektit ekonomik në më shumë se një vit. Pra, mjetet materiale subjektit ekonomik i sigurojnë përfitime në të ardhmen, përfitime që do t'i siguron më shumë se 12 muaj nga data e ndërtimit të pasqyrave financiare.¹

Evidenca kontabël e aktiveve afatgjatë mbahet në kuadër të librave afariste, ndër të cilat janë: libri i inventarizimit, ditari, libri kryesor me kontot sintetike, librat ndihmëse me kontot analitike, etj.

Për të pasë një evidencë kontabël sa më të saktë dhe më të lehtë, rëndësi ka edhe klasifikimi i tyre. Sipas autorëve të ndryshëm, ekzistojnë edhe kritere të ndryshme për klasifikimin e mjeteve materiale. Kontabiliteti i klasifikon ato sipas natyrës së tyre, dhe duke u bazuar në këtë kriter mjetet themelore (asetet) mund të klasifikohen në tri grupe kryesore:



Klasifikimi i mjeteve kryesore ndihmon edhe në paraqitjen e tyre në bilancin e gjendjes. Pavarësisht se a bëhet fjalë për mjetet kryesore në ndërtim (vijim), mjetet kryesore në përdorim, mjetet kryesore jashtë përdorimit apo në likuidim, kontabiliteti i mjeteve kryesore të subjektit ekonomik duhet të jetë ashtu i organizuar që të mundëson sigurimin e këtyre të dhënave për çdo mjet kryesor:

-vlerën furnizuese të mjeteve themelore, në të cilën janë përfshirë- vlera faturave plus të gjitha shpenzimet tjera të bëra rreth furnizimit të mjetit kryesor,

-amortizimin, vlerën e amortizuar apo vlera e shlyer e mjetit kryesor,

-vlerën e tanishme apo të pashlyer të mjetit kryesor,

-vlerën e rivalorizuar apo vlerën e rivlerësuar e mjeteve themelore dhe


-vlerën e likuidimit të mjeteve kryesore.²

¹ Sotiraq Dhama, parimet bazw tw kontabilitetit, Tiranw, 2010, faq.335.

Njohja e mirë e të pesë kategorive vlerore që paraqiten në evidencën kontabël të mjeteve kryesore, mundësojnë evidencën e tyre të saktë kontabël. Të paraqitura sipas grupeve karakteristike të mjeteve kryesore si dhe burimeve të tyre, kontot aktivë dhe pasivë do të ishin:

Emri i kontos	Aktivë	Pasivë
Mjetet kryesore në përdorim (funksion)	+	
Mjetet kryesore jashtë përdorimit	+	
Avanse për mjete kryesore	+	
Investimet në vijim	+	
Mjetet e ndara në para për investime	+	
Kredi për mjete kryesore		-
Furnitorët për mjetet kryesore		-

Kontot (llogaritë) e mjeteve kryesore (AAGJ) janë llogari të aktiveve dhe si të tilla edhe funksionojnë: në anën debi e kanë gjendjen dhe shtimin e tyre, ndërsa në kredi e kanë zvogëlimin apo pakësimin e tyre.



Kontoja “mjetet kryesore në përdorim (funksion)” përfshin të gjitha ndërrimet lidhur me mjetet kryesore të cilat gjinden në përdorim. Në këtë grup të kontove përfshihen: toka dhe pyjet, objektet ndërtimore, veglat për punë dhe mjetet e tjera themelore. Mjetet kryesore, të cilat nuk janë në përdorim përfshihen në konton “mjetet kryesore jashtë përdorimit”. Kontoja “avanset për mjetet kryesore” shërben për evidentimin e parapagesave apo paradhënieve të paguara, lidhur me ndërtimin apo furnizimin e mjeteve kryesore. Kjo konto shuhet apo mbyllet në momentin e likuidimit të avansit.

Funksioni i kontos “investimet në vijim” apo “mjetet materiale në ndërtim” është që t’i përfshijë të gjitha vlerat faturale (situacionet e përkohshme) dhe pagesat që bëhen në lidhje me furnizimin e mjeteve kryesore dhe me ndërtimin e objekteve në regji të huaj apo në regji të vet subjektit. Shuhet kur ndërtimi është kryer dhe objekti është dhënë në përdorim. Kjo konto përfshin edhe blerjen e mjeteve kryesore ku evidentohen të gjitha shpenzimet në lidhje me

² Serafim Tomovski, vep. e cituar, faq.138.

blerjen, duke filluar nga vlera e faturave plus të gjitha shpenzimet tjera varëse. Prej kësaj kontoje bartet vlera blerëse në kontot përkatëse të mjetit kryesor. Kontoja “mjetet e ndara në para për investime” përfshin mjetet në formë të parave, të cilat i janë dedikuar financimit të ndërtimit të mjeteve themelore.

Konto “kredi për mjete kryesore” përfshin detyrimet (obligimet) ndaj bankës në lidhje me kredinë e marur për ndërtimin apo blerjen e mjetit kryesor. Në konton “furnitorët për mjete kryesore” përcillen obligimet ndaj furnitorëve, në lidhje me ndërtimin apo blerjen e mjeteve themelore.

Në çdo subjekt ekonomik duhet të sigurohen informata për të gjitha mjetet kryesore me të cilat disponon. Informata paraqet përmbledhjen e rregullave të qartësuara, të prirjeve praktike dhe të metodave të punës sipas të cilave duhet të punojnë njerëzit ose grupet e njerëzve për futjen e të dhënave në evidencë, ku do të përpunohen dhe do të siguron të gjitha informatat, të cilat do t'i mundësojnë individit të vendosë për vendimmarrje afariste. Këto informata për mjetet kryesore duhet të jenë të plota dhe të kategorizuara në mënyra të ndryshme, duke filluar nga ajo elementarja (makinat, pajisjet, stabilimentet, toka bujqësore, toka ndërtimore, mjetet transportuese etj.) deri tek ato më të rëndësishmet- informatat financiare.

Pasi që mjetet kryesore (aktivet afatgjata) kanë afat të gjatë përdorimi, vlerë të madhe furnizuese për një njësi, shpenzim gradual dhe kanë aftësi për tu kthyer në formën e mëparshme, këto mjete, çdo subjekt ekonomik duhet t'i evidentojë në evidencat e mjeteve kryesore, për t'i mundësuar atij që të udhëheq me to, të përllogarit shpenzimin e tyre (amortizimin) dhe t'i shfrytëzojë sa më mirë.

Zakonisht në praktikë dhe në teori njihen dy lloje të evidencave: evidenca kontabël dhe evidenca teknike. Evidenca teknike e mjeteve kryesore bëhet në mbështetje të informatave që merren për mjetet dhe ajo gjindet së bashku me mjetin kryesor. Ajo në vete përmban: vitin e prodhimit, të dhënat mbi kapacitetin, aftësinë e lëvizjes, harxhimin e energjisë, të dhënat mbi harxhimet e mjetit etj.

Evidenca kontabël përcakton dhe evidenton të gjitha ndërrimet që bëhen, që nga blerja e mjetit kryesor gjer te harxhimi i plotë i tij në vlerë. Këto evidenca zakonisht bëhen në subjektet ekonomike, në kontabilitetin e mjeteve kryesore, kurse gjendja e tyre faktike bëhet me

inventarizimin e tyre, i cili bëhet në intervale të caktuara kohore (tremujore, gjashtëmujore apo një vjeçare) si inventarizime të rregullta apo të jashtzakonshme.

Varësisht nga nevoja për informacion subjekti ekonomik mund të përdorë kontot sintetike për grupet kryesore të mjeteve kryesore (AAGJ) dhe një herit mund të mbajë konto të veçanta analitike për çdo lloj të mjeteve kryesore, si p.sh.

K-to Sintetike		K-to Analitike					
D	K	D	K	D	K		
K-to Mj.transportuese		K-to Kamionat		K-to Traktorat		K-to Mikrobusat	
100.000		50.000		20.000		30.000	

Organizimi i mirë i evidencës së aktiveve afatgjata në kontabilitetin analitik nënkupton njohjen e mirë të vetive dhe specifikave në fushën konkurruese. Siç cekëm edhe më lartë, aktivet afatgjata lajmërohen në tre forma kryesore: në formën e investime jomateriale (të drejtave të caktuara), në formë e investimeve materiale dhe në formën e parave (si investime financiare afatgjata).

7.1. MJETET JOMATERIALE – AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE (AAGJJ)

7.1.1. Kuptimi i mjeteve jomateriale – të paprekshme


Mjetet jomateriale janë pasuri mbi të cilat subjekti ekonomik zotëron të drejtën pasurore, që i sjell fitim atij në më shumë vite dhe që nuk kanë përbërje dhe ekzistencë fizike. Këto mjete përfaqësojnë atë lloj të shpenzimeve të cilët i kryen subjekti ekonomik dhe në këmbim të të cilave nuk merr asgjë materiale, fizike ose të prekshme dhe të menjëhershme, por kontributi i tyre në fitimin e subjektit ekonomik pritet në vitet në vijim. Edhe këto mjete kontribuojnë në rezultatin financiar të subjektit ekonomik në më shumë vite, andaj edhe kostoja e tyre duhet të shpërndalet në këto periudha. Në kuadër të këtij grupi përmblihen të gjitha të dalurat (shpenzimet), të cilat shlyhen për një periudhë kohore më të gjatë se një vit, a të cilat (harxhime) nuk mund të futen (klasifikohen) në asnjë grup të mjeteve materiale. Aktivet afatgjata jomateriale, shikuar në aspektin funksional, nuk janë mjete në formën klasike të fjalës me anë të të cilave mund të veprohet.

Në mjetet jomateriale bëjnë pjesë:

- ❖ të dalat (shpenzimet) për studime dhe zhvillime teknologjike;
- ❖ të dalurat (shpenzimet) e themelimit ;
- ❖ gudvilli (goodwill);
- ❖ patentat, licencat, koncesionet, mostrat, modelet;
- ❖ simbolet mbrojtëse dhe të drejtat e ngjashme;
- ❖ investimet jomateriale në përgatitje
- ❖ avanset për të drejta jomateriale dhe
- ❖ të drejtat tjera jomateriale (komasacioni, arondimi).

Vlerën furnizuese apo blerëse të mjeteve jomateriale (AAGJJ) e përbëjnë shpenzimet e faturës blerëse dhe të gjitha shpenzimet e bëra rreth blerjes dhe sjelljes së mjeteve jomateriale tek subjekti ekonomik. Edhe amortizimi i mjeteve jomateriale bëhet në bazë të vlerës furnizuese të tyre, e cila më së shpeshti llogaritet sipas metodës lineare dhe pas afatit të pasurisë nuk posedon vlerë të mbetur (riziduale). Pra, në çdo periudhë kontabël gjatë së cilës përdoren mjetet jomateriale do të ngarkohet me shpenzimet e amortizimit në shuma të barabarta.

Evidentimi i mjeteve jomateriale bëhet në atë mënyrë që debiton kontoja gjegjëse për gjendjen fillestare dhe për çdo shtesë, ndërsa krediton për zvogëlimet apo pakësimet tek këto mjete. Këtë evidentim mund ta shprehim nëpërmjet kontos T të thjeshtëzuar në këtë mënyrë:



Mjetet jomateriale do të njihen në bilancin e gjendjes vetëm nëse:

- ky zë është i kontrollueshëm, pra ekziston, ka një dokument,
- është e mundur që përfitime të ndryshme ekonomike të realizohen nga aktivi,
- kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri.

Amortizimi i mjeteve jomateriale shpërndahet gjatë tërë jetëgjatësisë së tyre. Metoda më e shpeshtë e përlllogaritjes së amaortizimit tek mjetet jomateriale është metoda e amortizimit linear.

7.1.1.1. Shpenzimet (të dalurat) e themelimit

Në kuadër të të dalurave të themelimit regjistrohen: shpenzimet për studime dhe kërkim, shpenzimet e dokumentacionit projektues dhe dokumentacionit tjetër, shpenzimet për përgatitjen e kuadrit, premitë e sigurimit, kamata dhe shpenzimet e tjera në lidhje me themelimin e subjektit ose në lidhje me themelimin e një pjese organizative të subjektit, ose në lidhje me blerjen e instalimeve të subjektit ekonomik.

Të dalurat (shpenzimet), të cilat bëhen në periudhën përgatitore për themelimin e një subjekti të ri, ose shpenzimet që bëhen në subjektin ekzistues, por për futjen e ndonjë prodhimi të ri ose shërbimi, për hapjen e ndonjë fabrike të re, ose për zgjerimin e veprimtarisë në teritore të reja etj., sipas Rregullores për Planin kontabël, i emërtojmë si të dalura (shpenzime) të themelimit.

Shembull:

“Aida” Shpk për përgatitjen e kuadrit në lidhje me produktin e ri është bërë trajnimi i punëtorëve nga subjekti "Pro-ing" dhe furnitori (trajnuesi) ka dërguar faturën nr.17, në vlerë prej 20.500 denar, plus edhe 18% Tvsh.

Investimi është dhënë në përdorim.

K o n t o		p e r s h k r i m i	S h u m a	
debi	kredi		d e b i	k r e d i
		K-to Të dalurat e themelimit	20.500	
		K-to Kërkesa nga Tvsh-ja e paguar	3.690	
		K-to Detyrime ndaj furnitorëve në vend -sipas faturës nr.17		24.190

Mjetet	= Kapitali	+	Detyrimet
20.500 3.690			24.190

Për faturën e pranuar debiton kontoja “Të dalurat e themelimit” dhe krediton kontoja “Detyrime ndaj furnitorëve në vend”, ndërsa në debi gjithashtu kontohet edhe kontoja “Kërkesa nga Tvsh-ja e paguar”.

+K-to Të dalurat e themelimit -	+K-to Kërkes.nga Tvsh -	+ K-to Detyr.ndaj furnitorëve -
1) 20.500	1). 3.690	1) 24.190

Çka ndodh në bilancin e gjendjes?

Dy zëra bilancor rriten në aktivë (të dalurat e themelimit) dhe kërkesa nga Tvsh-ja e paguar.

Zëri tjetër bilancor po ashtu rritet në pasivë (detyrime ndaj furnitorëve); Shuma e bilancit rritet - si në aktivë ashtu edhe në pasivë për 24.190 den.

7.1.1.2. Evidentimi i patentave

Patenta është e drejtë që e ka autori i një risie tekniko teknologjike për ta mbajtur, përdorur apo shitur risin e tij. Që një shpikje të konsiderohet si patentë dhe të jetë objekt i shit-blejes, duhet së pari të vërtetohet që ajo përmban element të rinj në krahasim me teknologjinë ekzistuese.



E drejta mbi patentën është e drejtë e autorit deri në një periudhë të caktuar kohore e cila është e paraparë me ligj. Mbrohet nga shteti me të vetmin qëllim që inovatorët të stimulohen për shpikje të reja tekniko teknologjike. Patenta është objekt i shit-blejes. Kostoja e patentës shpreh çmimin blerës dhe në evidencën kontabël regjistrohet njëllonj sikurse edhe mjetet tjera jomateriale si dhe amortizimi bëhet gjatë tërë jetëgjatësisë së saj sipas metodës lineare.

Shembull: “Besa” Shpk me datë 23.02.20___, sipas mandat pagesës (arka paguan) nr. 34 ka blerë në kesh nga arka patentë për prodhimin e një produkti të rri në vlerë prej 34.500 den.

K o n t o		p e r s h k r i m i	S h u m a	
debi	kredi		debi	kredi
		K-to Patenta	34.500	
		K-to Arka		34.500
		sipas mandat pagesës nr. 34		

Mjetet = Kapitali + detyrimet

34.500

-34.500

Çka ndodh në bilancin e gjendjes ?

Një zë rritet në aktivin e bilancit (Patenta)

Një zë tjetër zvogëlohet po ashtu në aktiv (Arka)

Shuma e bilancit ngel e pandryshuar, ndryshon vetëm përbërja e aktivit

7.1.1.3. Evidentimi i licencave



Licenca në përgjithësi paraqet bartjen e të drejtës për shfrytëzim të patentit, modelit ose mostrës me anë të kontratës. Në kontabilitet, licenca (leja) nënkuptohet si kompensim për fitimin e një të drejte të tillë. Në evidencën kontabël regjistrohet në bazë të vlerës furnizuese dhe amortizimi zakonisht bëhet me metodën lineare

gjatë shfrytëzimit të saj. Në fund, gjatë tjetërsimit nuk ka vlerë riziduale.

Shembull:

“Aida” Shpk ka blerë licencë për prodhimin e produkteve të reja dhe nga furnitori ”Besniku” ka pranuar faturën nr.34 në vlerë prej 120.000 denar, plus edhe 18% Tvsh.

Regjistrimi në Shpk "Aida"

Konto		Përshkrimi	Shuma	
D	K		Debi	Kredi
		K-to Licencat	120.000	
		K-to Kërkesa nga Tvsh-ja e paguar	21.600	
		K-to Detyrime ndaj furnitorëve nga jashtë -sipas faturës nr.34 për blerjen e patentës		141.600

Për çdo faturë të pranuar nga furnitori debiton kontoja Licencat si dhe kontoja Kërkesa nga Tvsh-ja e paguar, ndërsa krediton kontoja Detyrime ndaj furnitorëve.

+ K-to Licencat	-	+ K-to Kërke nga Tvsh-jae pag.	-	+ K-to Detyr. ndaj furnit. nga jashtë	-
1) 120.000		1) 21.600			141.600

Çka ndodh në bilancin e gjendjes:

Dy zëra bilancor rriten në aktivë (licencat) dhe Kërkesa nga Tvshja e paguar
Zë tjetër bilancor po ashtu rritet në pasivë (detyrime ndaj furnitorëve);
Shuma e bilancit rritet - si në aktivë ashtu edhe në pasivë për 141.600 den.

7.1.1.4. Evidentimi i shenjave tregtare dhe emrat e shitjes



Shenjat tregtare si dhe emri i shitjes është shenjë, simbol, fjalë ose frazë e cila e identifikon një subjekt apo një produkti të caktuar. Me anë të shenjave tregtare subjektet ekonomike identifikohen në tregun kombëtar apo atë ndërkombëtar. Mbrojtja me ligj e shenjave tregtare ka për qëllim të mbrojtë shenjën apo emrin shitës nga kopjimi apo riprodhimi por pasi më parë të jetë regjistruar në zyrën shtetërore të të drejtave.

Në këtë konto sintetike regjistrohen: të drejtat e shenjës mbrojtëse; të drejtat e mostrës dhe modelit industrial; dituritë industriale (know-how); e drejta në dokumentacionin teknik dhe teknologjik; investimet në mjetet e huaja për punë; marrja me qira me afat të gjatë të mjeteve të huaja për punë; mjetet për punë të marra në lizing; investimet në përparimin e prodhimitarisë bujqësore (komasacioni, arondimi etj.); të drejta të tjera për investime jomateriale.

Sa i përket regjistrimit të këtyre të drejtave në kontabilitet, ai bëhet në mënyrë të njëjtë sikurse edhe të drejtat e tjera të përmendura më lartë.

Shembull: SHA projektuese "Tek-ing" ka lëshuar faturën nr.117 në vlerë prej 215.000 denar plus edhe 18% Tvsh, në lidhje me dorëzimin e dokumentacionit teknik-shenjat mbrojtëse.

K o n t o		P ë r s h k r i m i	S h u m a	
debi	kredi		debi	kredi
		K-to Shenjat mbrojtëse dhe të drejtat tjera	215.000	
		K-to Kërkesa nga Tvsh-ja e paguar	38.700	
		K-to Detyrime ndaj furnitorëve në vend sipas f-rës nr.117		253.700

Për faturën e pranuar nga furnitori debiton kontoja Shenjat mbrojtëse dhe Kërkesa nga Tvsh-ja e paguar, ndërsa krediton kontoja Detyrime ndaj furnitorëve.

+ K-to Shenjat mbrojtëse -	+K-to Kërkes.nga Tvsh e paguar-	+ K-to Detyr.ndaj furnitorit -
1. 215.000	1. 38.700	1. 253.700

Çka ndodh në bilancin e gjendjes:

Rriten dy zë bilancor në aktivë (shenjat mbrojtëse dhe Kërkesa nga Tvsh-ja);
Zë tjetër bilancor po ashtu rritet në pasivë (detyrime ndaj furnitorëve j.v.);
Shuma e bilancit rritet - si në aktivë ashtu edhe në pasivë për 253.700 den.

E tëra kjo e cila u sqarua, në lidhje me evidencën kontabël, për disa lloje të mjeteve jomateriale vlen për të gjitha mjetet tjera jomateriale.



7.1.1.5. Evidentimi i koncesionit

Koncesioni paraqet dhënien e të drejtës për eksplotim të të mirave me interes të përgjithshëm shtetëror (si p.sh. zhfrytëzimi i maleve me gurrë mermeri për nxjerrjen e mermerit, nxjerrjen e xeheve etj.), respektivisht kryerje të afarizmit ose punëve, në lidhje me të mirën me interes të përgjithshëm shtetëror (si p.sh. zhfrytëzimi i ujërave etj).

7.1.1.6. E drejta e autorit

E drejta e autorit është e drejtë e dhënë nga qeveria e shtetit nëpërmjet të cilës mbrohet riprodhimi (fotokopjimi) dhe shitja e librave, veprave letrare apo veprave artistike. Kjo e drejtë u garantohet autorëve në një afat prej 50 viteve, gjë që nënkupton se gjatë këtyre viteve edhe amortizohet kjo e drejtë, me një shkallë të amortizimit prej 2%. Si edhe mjetet tjera jomateriale, në kontabilitet evidentohet me vlerën furnizuese (blerëse).

7.1.1.7. Evidentimi i franshizës

Franshiza është e drejtë të cilën e përfiton subjekti nga një subjekt tjetër për të zhvilluar aktivitet brenda kushteve specifike në regjione të caktuara gjeografike. P.sh. e drejta e afarizmit në kuadër të zinxhirit të hoteleve “Sheraton”, “Hilton”, “Intercontinental”, restorantet Mc Donalds, Burger King, etj. Në kontabilitet regjistrimi bëhet në anën debi të kontos “franshizat” në lartësi të vlerës furnizuese.

7.2. MJETET MATERIALE AFATGJATA – AAGJM

7.2.1. Kuptimi i mjeteve materiale afatgjata

Subjekti ekonomik për t’i përmbushur detyrat dhe synimet e saja ajo detyrimisht duhet të disponon me mjete të caktuara materiale si në aspektin sasiorë ashtu edhe në llojlloshmërinë e tyre. Llojet dhe sasia e mjeteve me të cilat duhet të disponon një subjekt ekonomik gjatë afarizmit të saj, varen kryesisht nga lloji i aktivitetit afarist.

Mjetet materiale (aktivet afatgjata materiale-AAGJM) janë të gjitha ato mjete të cilat kanë përbërje fizike pra, materializohen në një formë të caktuar. Të njëjtat mund të preken, të shihen dhe të maten fizikisht. Nga pikpamja e kontabilitetit mjetet materiale (AAGJM) paraqesin shpenzime të parapaguara materiale, për shkak se subjekti ekonomik përfitimet nga këto shpenzime pret t’i marrë në të ardhmen.

Qëllimi i evidencës së mjeteve materiale është që të sigurohet një informacion sa më i saktë, i cili do të ndihmojë në menaxhimin e subjektit ekonomik, pastaj do të ndihmojë në drejtimin e secilit grup të mjeteve materiale në lidhje me gjendjen fillestare, furnizimin dhe

tjetërsimin e tyre, si dhe lidhje me shpenzimin (amortizimin) e tyre. Pra, evidenca e mjeteve materiale ndihmon në administrimin dhe ruajtjen e tyre si dhe në përcaktimin e saktë të shpenzimeve të tyre në koston e produkteve, mallrave apo shërbimeve për periudhën përkatëse kontabël.

Ashtu siç edhe tek mjetet jomateriale, problemet themelore janë: përcaktimi i vlerës hyrëse (furnizuese), evidenca sintetike dhe analitike, regjistrimi i hyrjes dhe daljes së tyre dhe përcaktimi i vlerës së amortizimit.

Përcaktimi i vlerës furnizuese (shpenzimeve furnizuese) - Vlera furnizuese e mjeteve materiale (AAGJM) përfshin vlerën faktuale të furnitorit, si dhe të gjitha shpenzimet tjera të bëra rreth këtij furnizimi deri tek dhënia e tyre në përdorim. Në këto shpenzime bëjnë pjesë: shpenzimet e transportit, ngarkimit, shkarkimit, sigurimit, çmontimit, montimit, shpenzimet e doganës, trajnimit, etj.

VLERA FURNIZUESE E AAGJM =

1. VLERA FATURALE NGA FURNITORI (çmimi i blerjes) +

2. SHPENZIMET VARËSE (shpenzimet e transportit, ngarkimit, shkarkimit, sigurimit, çmontimit, montimit, shpenzimet e doganës, trajnimit, etj


Tek subjektet prodhuese një kamionetë paraqet produkt i gatshëm, tek subjekti tregtar e njejtë kamionetë paraqet mall tregtar, ndërsa tek një prodhues i mobiljeve kjo kamionetë shërben për transportin e mobiljeve dhe e njejtë paraqet mjet kryesor (aset). Vlera furnizuese i përfshinë të gjitha shpenzimet reth furnizimit të kamionetës, si p.sh.

Vlera faktuale e kamionetës.....	100.000
--Zvogëlim: Zbritje për pagesë e menjëhershme (2%)	2.000
Neto çmimi për pagesë	98.000
TVSH 18% (98.000 x 18%)	17.640
Transporti	2.360
Transporti nga stacioni hekurudhor deri tek subjekti ekonomik	1.000
Shpenzimet e sigurimit gjatë transportit	1.000
Shpenzimet e furnizimit të kamionetës	120.000 den.

Procesi i planifikimit dhe i parashikimit për të dhëna kapitale quhet buxhetimi kapital. Buxhetimi kapital përfshin vendimet siç janë: a të ndërtohen fabrika të reja, a të blehet kompania konkurruese apo të zhvillohen produkte të reja. Vendimet që kanë të bëjnë me blerjen e mjeteve kryesore (aseteve) mundë të jenë ndër vendimet më të rëndësishme që i sjell ekipi menaxhues. Këto blerje shpesh angazhojnë shuma shumë të larta monetare. Nëqoftëse subjekti ekonomik duhet të dizajnon dhe konstrukton mjetet kryesore, të dhënat monetare për blerjen e tyre mundë të zgjasin edhe disa vite. Përveç kësaj, blerja e mjeteve kryesore mund të ndikon në natyrën dhe efikasitetin e afarizmit të subjektit ekonomik në disa vite të ardhshme.

Faktori kryesor tek shumica e vendimeve të buxhetimit kapital është vlerësimi i menaxhmentit në rrjedhat e mjeteve monetare të lidhura me atë projekt, respektivisht, në derrdhjen e parave që janë të nevojshme për blerjen e mjetit të ri si dhe të hyrave neto vjetore të parave që prit ti sjellë ky mjet i ri. Pra, vendimi për blerjen e mjetit kryesor është shumë i rëndësishëm, pasi që mund të ketë ndikim afatgjatë në afarizmin e subjektit ekonomik dhe evidencat kontabël – veçanërisht fluksi i mjeteve monetare dhe fitimi, luajnë po ashtu një rol të rëndësishëm tek këto vendime.

Evidentimi i mjeteve materiale është i njëjtë siç edhe tek mjetet jomateriale, që do të thotë se debiton kontoja gjegjëse për gjendjen fillestare dhe për çdo shtesë, ndërsa krediton për zvogëlimet apo pakësimet tek këto mjete. Këtë evidentim mund ta shprehim në mënyrë skematike të thjeshtëzuar në këtë mënyrë:



Evidenca e mjeteve materiale bëhet duke u mbështetur në dokumentet origjinale, të cilat një herit e vërtetojnë transaksionin në lidhje me mjetet materiale. Së pari, në kontabilitet transaksionet do të regjistrohen në urdhëresën për regjistrim, pastaj në ditar në mënyrë kronologjike, më pas do të bëhet evidenca nëpër kontot e tyre gjegjëse në librin e llogarive dhe në fund bëhet edhe regjistrimi i shpenzimit të tyre apo amortizimit.

Duhet theksuar fakti se ekzistojnë më tepër mënyra për furnizimin e mjeteve materiale (AAGJM) siç janë: marrja pa kompensim, blerja e tyre (me mjete vetanake, me kredi dhe me mjete të kombinuara), ndërtimi i ndërtesave (me mjete vetanake, me kredi dhe me mjete të kombinuara). Por përveç furnizimit të mjeteve materiale ekziston edhe dalja e tyre, respektivisht shitja e tyre, dhënia falas, nxjerrja jashtë përdorimit, amortizimi etj.

Mjetet materiale përkufizohen si element të aktivit që:

-kanë substancë ose formë fizike;

-kohëzgjatja e përdorimit parashikohet dhe përlllogaritet për më shumë se një vit kontabel.

Aktivitet afatgjata dokumentohen në bazë të këtyre dokumenteve: kontrata, fatura e furnitorit, flet-hyrja, akte të ndryshme, procesverbale, pasqyra e llogaritjes së amortizimit, etj.

7.2.2. Klasifikimi i aktiveve afatgjata materiale-AAGJ

Aktivitet afatgjata shikuar në aspektin funksional, lajmërohen në dy grupe:

- investime në furnizimin e pasurive natyrore,
- investime në mjetet për punë.



– Tokat dhe pyjet



– Objektet ndërtimore



– Pajimet dhe makineritë



zyrave, mobilet dhe mjetet transportuese

– Veglat, inventari i repartit dhe



- Aktivet biologjike,

- Aktivet e tjera materiale, Aktivet materiale në ndërtim
- Avanset për furnizimin e aktiveve materiale , Barazimet vlerore të aktiveve materiale
- Amortizimi i akumuluar i aktiveve materiale.

Për shkak të mundësive të ndryshme të blerjes, ndërtimit të aktiveve afatgjata, mundësive të ndryshme të financimit paraqiten edhe regjistrime të ndryshme. Në vazhdim do të njihemi me disa nga këto mundësi të furnizimit të aktiveve afatgjata si dhe evidentimin e tyre në evidencën kontabël.

7.3. EVIDENCA E FURNIZIMIT TË TOKËS

Gjatë evidentimit kontabël të furnizimit të tokës si tokë pune apo tokë për ndërtim, duhet të përcaktohet çmimi furnizues, ku përveç çmimit blerës bëjnë pjesë edhe të gjitha shpenzimet tjera përcjellëse, që njihen si shpenzime varëseç.

Duhet theksuar se toka si mjet afatgjatë në evidencën kontabël mbahet në llogari të veçantë pasi për tokën nuk llogaritet dhe evidentohet zhvlerësimi, harxhimi apo amortizimi.

Shembull:

“Aida” Shpk me datë 03.11.2013, sipas faturës nr. 23, nga furnitori “Pologu” Shpk, ka blerë tokë në vlerë prej 800.000 denarësh plus 18% Tvsh. Në emër të tatimeve nga arka ka paguar 24.000 den, e për shpenzimet e matjes 6.000 den. Toka është dhënë në përdorim. Kontimi mund të bëhet në dy mënyra:

1. Mënyra me Fletëkalkulim:

Vlera faturale	800.000
Tatimet	24.000

Shpenzimet e matjes	6.000
Vlera blerëse:	830.000 den.
TVSH-ja (800.000 x 18%)	144.000

K o n t o		P ë r s h k r i m i	S h u m a	
debi	kredi		d e b i	k r e d i
		K-to Toka	830.000	
		K-to Kërkesa nga Tvsh-ja e paguar	144.000	
		K-to Detyrime ndaj furnitorëve		944.000
		K-to Arka		30.000
		Blerja e mjeteve themelore-tokës		

2. Mënyra kontabël

	K-to		P Ë R S H K R I M I	SHUMA	
	D	K			
1			K-to Mjetet materiale në përgaditje	800.000	
			K-to Kërkesa nga Tvsh-ja e paguar	144.000	
			K-to Detyrime ndaj furnitorëve		944.000
			Blerja e tokës sipas faturës nr.23		
2			K-to Mjetet materiale në përgaditje	30.000	
			K-to Arka		30.000
			për shitjen e objektit		
3			K-to Toka	830.000	
			K-to Mjetet materiale në përgaditje		830.000
			Dhënja në përdorim		

Mjetet	=	Kapitali	+	Detyrimet
830.000				944.000
144.000				
-30.000				

Në këtë rast rritet vlera e kontos së përkohshme “**mjetet materiale në përgaditje** për vlerën faktuale (blerëse), ndërsa në të njëjtën kohë rriten “detyrimet ndaj furnitorëve”. Po ashtu në ndrimin nr.2, për shpenzimet varëse rreth blerjes tokës debiton kontoja “mjetet materiale në përgaditje” ndërsa krediton kontoja “arka” për vlerën e paguar. Në momentin kur nuk ka më

shpenzime tjera rreth furnizimit atë herë në ndërimin nr.3, debiton kontoja “toka” ndësa mbyllet kontoja e përkohshme “mjetet materiale në përgaditje” duke u kontuar në anën kredi.

7.3.1. Evidenca e përmisimeve në tokë

Përmisimet që bëhen në tokë, siç janë kanalet e ujitjes, kanalet e kullimit, rrugët, ndriçimi, rrethojat, etj. kanë afatin e tyre të përdorimit dhe njëherit ndaj tyre llogaritet dhe evidentohet zhvlerësimi. Andaj, të gjitha këto shpenzimet që bëhen për përmirësimin e tokës evidentohen në kontën e veçantë “përmirësimet në tokë”.

Shembull:

“Besa” Shpk në tokën punuese të saj, sipas raportit të arkës nr. 34 te datës 22.03. 2013, ka investuar rreth kanalit ujites 16.500 den., për rethimin e saj 37.500den, të cilat i ka paguar nga arka. Kostoja totale e përmirësimit të tokës është 54.000 den.

	K-to		P Ë R S H K R I M I	SHUMA	
	D	K			
1			K-to Përmirësimet në tokë K-to Arka Pagesa sipas raportit të arkës nr. 34	54.000	54.000

Mjetet = Kapitali + Detyrimet 54.000 - 54.000
--

Çka ndodh në bilancine e gjendjes?

Një zë bilancor rritet në aktivë (përmirësimi në tokë) dhe një zë tjetër zvogëlohet po ashtu në aktivë (Arka). Shuma e bilancit ngel e pandryshuar.

7.4. EVIDENCA E FURNIZIMIT TË MJETEVE KRYESORE

7.4.1. Evidenca e marrjes së mjeteve kryesore pa kompensim

Subjektet ekonomike, në raste të veçanta, mund të marrin mjete kryesore pa kompensim nga ana e subjekteve të tjera ekonomike apo nga organizata të ndryshme. Në rastet kur merret mjete kryesore falas, shkakton këtë ndërrim kontabël: rritje në anën pozitive, debi të kontos “**mjetet kryesore në përdorim**” dhe rritje në anën negative (kredi) të kontos “*rritja e kapitalit të pronarit*” ose k-to “*të hyrat e jashtëzakonshme*”.

Shembull:

Nga Shpk “Agimi” kemi marrë falas (pa kompensim) një depo (objekt ndërtimorë) tërësisht i ri në vlerë prej 280.000 denar.

K o n t o		p ë r s h k r i m i	S h u m a	
debi	kredi		debi	kredi
	ose	K-to Objektet ndërtimore K-to Rritja e kapitalit të pronarëve (K-to Të hyrat e jashtëzakonshme) marrja e pajimit pa kompenzim	280.000	280.000

$$\text{Mjetet} = \text{kapitali} + \text{detyrimet}$$

$$280.000 \quad 280.000$$

+ K-to Objektet ndërtimore - <hr style="border: 1px solid black;"/> 1). 280.000	+ K-to Rritja e kapitalit të pronarëve - <hr style="border: 1px solid black;"/> 1). 280.000
--	--

Çka ndodh në bilancin e gjendjes:

Rritet një zë bilancor në aktivë (Objektet ndërtimore);
Zë tjetër bilancor po ashtu rritet në pasivë (Rritja e kapitalit të pronarit ose Të hyrat e jashtëzakonshme);
Shuma e bilancit rritet - si në aktivë ashtu edhe në pasivë për 280.000 den.

Shembull:

Nga “Ylli” Shpk është marrë pa kompensim mjete kryesor (mjet transportues) në vlerë prej 350.000 den. ndërsa vlera e shlyer ka qenë 50.000 den.

K o n t o		P ë r s h k r i m i	S h u m a	
debi	kredi		d e b i	k r e d i
		K-to Mjetet transportuese K-to Korigjimi i vlerës së mjet.kryesore K-to Rritja e kapitalit të pronarëve marrja e mjetit kryesor pa kompenzim	350.000	50.000 300.000

Mjetet = Kapitali + Detyrimet
350.000 300.000
-50.000

+ K-to Mjetet transportuese -	+ K-to KVMK	-	+ K-to Rritja e kapit.pronarit
350.000	50.000		300.000

Çka ndodh në bilancin e gjendjes:

Rritet një zë bilancor në aktivë (mjetet transportuese);
Zëra tjetër bilancor po ashtu rriten në pasivë (Rritja e kapitalit të pronarit dhe Korigjimi i vlerës së mjeteve kryesore);
Shuma e bilancit rritet - si në aktivë ashtu edhe në pasivë për 350.000 den.

7.4.2. Evidenca e blerjes së mjeteve kryesore

Blerja e mjeteve kryesore, (makina, pajimeve, instalimeve apo mjeteve transportuese) para së gjithash, financohet nga mjetet vetanake me të cilat disponon subjekti ekonomik. Pagesa e blerjes së mjeteve kryesore bëhet nga mjetet monetare që gjinden në xhirollogari si dhe nga mjetet e ndara në para për investime, të cilat mjete kryesisht janë të dedikuara për blerjen e mjeteve kryesore. Në të dyja rastet zvogëlohen mjetet monetare në të dy kontot dhe regjistrimi i tyre bëhet në anën negative (kredi) të kontove gjegjëse.

Financimi i blerjes së mjeteve kryesore, mund të bëhet edhe nëpërmjet kredisë së aprovuar për mjete kryesore, kredi të cilën e merr subjekti ekonomik nga bankat afariste pas prezantimit të biznes planit. Në këtë rast krediton kontoja “Detyrime ndaj kredisë për mjete

kryesore”. Po ashtu financimi i blerjes së mjeteve kryesore mund të bëhet edhe prej mjeteve të kombinuara, pjesërisht prej mjeteve vetanake dhe pjesërisht nga kredia e aprovuar.

Vlerën furnizuese (fillestare) të mjeteve të blera e formon vlera blerëse-faturale. ku si dokument kryesor praqitet fatura e furnitorit si dhe dokumente tjera që kanë lidhshmëri me atë furnizim, siç janë: faturat për transport, për ngarkim dhe shkarkim, për montim, trajnim, sigurim, deklarata doganore, obligimet tatimore, situacionet e përkohshme, fletëngarkesat, faturat interne etj. deri sa mjeti kryesor jepet në përdorim. Në momentin e pranimit të faturës për furnizimin e mjetit kryesor debiton K-to Mjetet materiale në përgatitje, në të cilën konto evidentohet vlera faturale e mjetit kryesor si dhe të gjitha shpenzimet e tjera varëse. Po ashtu për vlerën e TVSH kontimi bëhet në anën debi të K-tos Kërkesa për TVSH e paguar. Në anën kreditore kontohet në K-to Detyrime ndaj furnitorit. Kur nuk do të ketë shpenzime të tjera rreth këtij furnizimi, kontoja e përkohshme -mjetet materiale në përgatitje, do të shuhet (kontohet në anën kreditore) me kontim të njëhershëm në anën debitore të K-tos Mjetet materiale.

7.4.3. Evidentimi i blerjes së mjeteve kryesore nga mjetet vetanake

Kur blerja e mjeteve kryesore financohet tërësisht nga mjetet vetanake, të cilat i disponon subjekti ekonomik, ndërrimet shprehen në kontabilitet si ndryshim në strukturën e aktivitetit. Në këtë rast rritet vlera e **mjeteve kryesore në përdorim** për vlerën furnizuese (blerëse) ndërsa në të njëjtën kohë zvogëlohet *xhirollogaria*.

Shembull:

1. “Besa” Shpk nga Gostivari sipas faturës nr.7 të datës 11.02.20__ nga “A & B” SHA ka blerë një makinë në vlerë prej 460.000 den. plus edhe 18% TVSH.

2. Për shpenzimet e transportit dhe montimit nga “S-transport” Shpk, është pranuar fatura nr.41 e datës 15.02.20__ në vlerë prej 50.000 den. plus edhe 18% TVSH.

3. Makina është dhënë në përdorim.

4. Sipas ekstraktit të bankës nr. 23 të dy furnitorëve tërësisht u është paguar detyrimi nga xhirollogaria.

1. Metoda me fletëkalkulim:

Fatura blerëse nr.7

$$460.000 \times 18\% = 82.800 = 542.800$$

Fatura e transportit nr. 41

$$\frac{50.000}{50.000} \times 18\% = \frac{9.000}{9.000} = 59.000$$

Vlera blerëse pa TVSH

$$\mathbf{510.000} \quad \leftarrow \mathbf{91.800}$$

TVSH-ja (510.000 x 18%)

91.800

K o n t o		P ë r s h k r i m i	S h u m a	
debi	kredi		debi	kredi
		K-to Makina	510.000	
		K-to Kërkesa nga Tvsh-ja e paguar	91.800	
		K-to Detyrime ndaj furnitorit "A&B"		542.800
		K-to Detyrime ndaj furnitorit "S-transp."		59.000
		<u>Blerja e mjeteve themelore-tokës</u>		
		K-to Detyrime ndaj furnitorit "A&B"	542.800	
		K-to Detyrime ndaj furnitorit "S-transport"	59.000	
		K-to Xhirollogaria		601.800
		Paguar sipas ekstraktit të bankës nr.23		

2.Metoda kontabël

K o n t o		P ë r s h k r i m i	S h u m a	
debi	kredi		debi	kredi
		K-to Mjetet materiale në përgaditje	460.000	
		K-to Kërkesa nga TVSH-ja e paguar	82.800	
	1.	K-to Detyrime ndaj furnitorëve		542.800
		<u>Blrja e makinës sipas faturës nr. 7</u>		
		K-to Mjetet materiale në përgaditje	50.000	
	2.	K-to Kërkesa nga TVSH-ja e paguar	9.000	
		K-to Detyrime ndaj furnitorëve		59.000
		<u>Shpenzimet e tran.mont.sipas faturës 41</u>		
		K-to Paimet (makinat)	510.000	
	3.	K-to Mjetet materiale në përgaditje		510.000
		<u>dhënja e makinës në përdorim</u>		
		K-to Detyrime ndaj furnitorit "A&B"	542.800	
	4.	K-to Detyrime ndaj furn."S-transport"	59.000	
		K-to Xhirollogaria		601.800

+ K-to Mjetet materiale në përgaditje		-
1.	460.000	3. 510.000
2.	50.000	
	<u>510.000</u>	<u>510.000</u>

+ K-to Detyrime ndaj furnitorit "A&B"		-
4.	542.800	1. 542.800

+ Kërkesa nga pagesa e TVSH		-
1.	82.800	
2.	9.000	
	<u>91.800</u>	
K-to Xhirollogaria		-
	4.	601.800

+ K-to Detyrime ndaj furnitorit "S-transport"		-
4.	50.000	2. 50.000
+ K-to PAIMET (makinat)		-
	3.	510.000

Në ndërrimin e parë dhe të dytë kemi rritje në konton e përkohshme "mjetet materiale në përgaditje" dhe e njëjta kontohet në anën pozitive të kontos gjegjëse, si dhe rriten kërkesat për TVSH e paguar, që po ashtu kontohen në anën pozitive të kontos "Kërkesa nga TVSH-ja e paguar". Në të njëjtën kohë na rriten edhe obligimet ndaj furnitorëve, dmth. regjistrimi i rritjes së detyrimeve ndaj furnitorëve bëhet në anën negative (kredi) të kontos "detyrime ndaj furnitorëve". Me pagesën e furnitorëve janë zvogëluar detyrimet dhe kontimi bëhet në anën pozitive të kontos "**detyrime ndaj furnitorëve**", por në të njëjtën kohë kemi edhe zvogëlim të mjeteve monetare, që shkakton regjistrim në anën negative të kontos "xhirollogaria". Kur mjeti themelor, në këtë rast makina, është dhënë në përdorim, rritet kontoja "**makinat**" dhe regjistrimi bëhet në anën pozitive, ndërsa kontoja e përkohshme "mjetet materiale në përgaditje" mbyllet me bartjen e saldos së sajë në anën negative të kontos gjegjëse.

Çka ndodh në të gjitha ndërimeve në bilancin e gjendjes?

Rritet një zë bilancor në aktivë (Paimet - makinat);

Zë tjetër bilancor zvogëlohet në aktivë (Xhirollogaria);

Shuma e bilancit ngel e njëjtë - ndryshon struktura e aktivit.

7.4.4. Evidentimi i blerjes së mjeteve kryesore prej mjeteve të kombinuara

Blerja e mjeteve kryesore mund të financohet me mjetet të kombinuara, pjesërisht me mjete vetanake dhe pjesërisht prej kredisë së aprovuar nga bankat për furnizimin e mjeteve kryesore. Bankat afariste aprovjnë kredi subjekteve afariste në bazë të biznes planeve. Po qe se

ekspertet e bankës e vlerësojnë pozitivisht biznes planin, atë herë ata mund të aprovojnë kredi subjektit afarist.

Shembull:

1. “Aida” Shpk sipas faturës nr.12 të datës 11.03.20__ ka furnizuar nga “Driloni” Shpk një makinë në vlerë prej 230.000 den. plus edhe 18% TVSH.

2.Nga “Agimi” Shpk kemi pranuar faturën nr.25 të datës 12.03.20__ për montimin e makinës në vlerë prej 23.000 den. plus edhe 18% TVSh.

3.Pagesa e furnitorit “Driloni” Shpk më vlerë prej 271.400 den. është bërë nga kredia për mjete kryesore, ndërsa ndaj furnitorit “Agimi” Shpk është bërë nga xhirrollogaria, sipas ekstraktit të bankës nr. 17 në vlerë prej 27.140 den.

4. Makina është dhënë në përdorim.

Çmimi fatural nr.12	230.000 x 18% = 41.400 = 271.400
Fatura e montimit nr.25	23.000 x 18% = 4.140 = 27.140
	<u>253.000 45.540 289.540</u>

1. Metoda kontabël

K o n t o		P p ë r s h k r i m i	S h u m a	
debi	kredi		d e b i	k r e d i
		K-to Mjetet materiale në përgaditje K-to Kërkesa nga TVSH-ja e paguar K-to Detyrime ndaj furnitorëve furnizimi i makinës sipas f-rës nr.	230.000 41.400	271.400
		K-to Mjetet materiale në përgaditje K-to Kërkesa nga TVSH-ja e paguar K-to Detyrime ndaj furnitorëve montimi i makinës sipas f-rës nr.17	23.000 4.140	27.140
		K-to Detyrime ndaj furnitorëve K-to Detyrime ndaj furnitorëve K-to Detyrime ndaj kredive për MK K-to Xhirrollogaria pagesa e furnitorëve	271.400 27.140	271.400 27.140
		K-to Makina K-to Mjetet materiale në përgaditje dhënja e makinës në përdorim	253.000	253.000

Mjetet	=	kapitali + detyrimet
253.000 +41.400 +4.140		271.400
- 27.140		

Për çdo faturë të pranuar nga furnitori debiton K-to Mjetet materiale në përgaditje dhe K-to Kërkesa nga TVSh-ja e paguar, ndërsa krediton K-to Detyrime ndaj furnitorëve. Kur bëhet pagesa e furnitorit debiton K-to Detyrimet ndaj furnitorëve ndërsa krediton K-to nga e cila është bërë pagesa, në këtë rast nga K-to Detyrime ndaj kredisë për mjete kryesore dhe nga K-to Xhirollogaria. Kur mjeti jepet në përdorim, debiton K-to Makinat ndërsa krediton me tërë shumën e vet K-to Mjetet materiale në përgaditje.

Çka ndodh në bilancin e gjendjes ?

Rritet një zë bilancor në aktivë (Makinat) dhe zvogëlet një zë tetër Xhirollogaria;
Zë tjetër bilancor rritet në pasivë (Detyrime ndaj kredive për mjete kryesore);
Shuma e bilancit rritet - si në aktivë ashtu edhe në pasivë

7.4.5. Evidentimi i objekteve ndërtimore

Me objekte ndërtimore nënkuptohen ndërtesat dhe objektet tjera të cilat shërbejnë për realizimin e veprimtarisë afariste të subjektit ekonomik. Struktura e objekteve ndërtimore varet nga lloji i veprimtarisë ekonomike të subjektit afarist. Deri tek zotërimi i objekteve, të cilat i përdorim në aktivitetin afarist, subjektet ekonomike vijnë në disa mënyra:

- a). me blerjen e objekteve të gatshme;
- b). me marrje falas të objekteve;
- c). me ndërtimin e objekteve nga subjekte tjera ndërtuese dhe
- ç). me ndërtimin e objekteve nga vet subjekti.

Financimi i objekteve ndërtimore mund të bëhet prej mjeteve vetanake, prej mjeteve kredi si dhe me mjete të kombinuara. Kur blehen objekte të gatshme në vlerën furnizuese përfshihet çmimi i blerjes, shpenzimet e renovimit dhe riparimeve si dhe të tëra shpenzimet tjera që e bëjnë objektin të gatshëm për përdorim.

Në qoftë se ndërtimi i objektit bëhet nga vet subjekti ekonomik, pra në rezhi vetanake, në koston e objektit përfshihet kostoja e ndërtimit si dhe të gjitha shpenzimet tjera të nevojshme siç janë puna direkte, materiali direkt, shpenzimet për projektet dhe lejen e ndërtimit, shpenzimet e sigurisë gjatë ndërtimit si dhe shpenzime tjera përcjellëse gjatë ndërtimit.

Kur objektet ndërohen me kontraktim të subjekteve ndërtimore, atëherë vlerën furnizuese (fillestare) të objektit e përbënë vlera neto e kontraktuar (shuma e situacioneve të përkohshme) si

dhe të tëra shpenzimet tjera të nevojshme për ta bërë objektin të gatshëm për përdorim. Objektet ndërtimore, si pasuri e patundshme, janë subjekt i zhvlerësimit.

Shembull:

1.Kemi blerë një depo e cila ka qenë në përdorim dhe për të nga furnitori kemi pranuar faturën nr.21 prej 200.000 + 18% TVSH.

Nr	Konto		PERSHKRIMI	SHUMA	
	+	-		D	K
1			K-to Objektet ndërtimore K-to Kërkesa nga TVSh e paguar K-to Detyrimet ndaj furnitorëve blerja e depos sipas faturës nr. 21	200.000 36.000	236.000

Mjetet	=	kapitali	+ detyrimet
200.000			236.000
36.000			

Gjatë blerjes së objekteve ndërtimore nga furnitorët debiton kontoja Objektet ndërtimore dhe kontoja Kërkesat nga Tvsh-ja, ndërsa krediton kontoja Detyrime ndaj furnitorëve me vlerën e sajë faturale.

+ K-to Objektet ndërtimore -	+K-to Kërksa nga TVSH-	+ K-to Detyr.ndaj furnitor. -
1. 200.000	1. 36.000	1. 236.000

Çka ndodh në bilancin e gjendjes ?

Rritet një zë bilancor në aktivë (Objektet ndërtimore);
Zë tjetër bilancor po ashtu rritet në pasivë (Detyrime ndaj furnitorëve);
Shuma e bilancit rritet - si në aktivë ashtu edhe në pasivë.

Për çdo blerje të objekteve ndërtimore, evidentimi është i njëjtë si më lartë, me një ndryshim që për çdo pagesë zvogëlohen mjetet adekuate, qofshin ato mjete monetare vetanake apo mjete monetare të mara si kredi.

7.4.6. Blerja në grup e mjeteve materiale

Në bazë të kushteve të tregut, ndodh që subjektet ekonomike të blejnë ndonjëherë me një çmim të përbashkët tokën dhe ndërtesën. Në raste të tilla, nga aspekti kontabël është me rëndësi të përcaktohet kostoja fillestare e blerjes së objektit dhe tokës. Kjo ka rëndësi në kontabilitet, pasi siç dihet toka nuk është pasuri e zhvlerësueshme, ndërsa objekti ndërtimor është pasuri e zhvlerësueshme, andaj edhe përcaktimi i kostos së tyre ka rëndësi dhe ndikim të drejtpërdrejt në rritjen e shpenzimeve. Kostoja e blerjes në grup e mjeteve materiale shpërndahet në kuadër të grupeve të veçanta të mjeteve në bazë të vlerave relative të tregut për llojet e ndryshme të mjeteve të blera.

Shembull:

“Aida” Shpk ka blerë një repart prodhimi së bashku me lokacionin (tokën) në të cilën gjindet reparti, në vlerë prej 1.500.000 den. plus edhe 18% Tvsh.

Është vlerësuar se sikur të bliheshin ndaras, atë herë sipas vlerës së tregut do të kushtonin: toka 1.200.000 den, ndërsa objekti (reparti i prodhimit) 800.000 den. Mbi bazën e vlerës së tregut vlerësohet çmimi i blerjes në grup.

$$1.200.000 / 2.000.000 \times 100 = 60\% \quad ; \quad 800.000 / 2.000.000 \times 100 = 40\%$$

	Vlerësimi		Ndarja	
Toka	1.200.000	60%	900.000	(1.500.000 x 60%)
Objekti	800.000	40%	600.000	(1.500.000 x 40%)
Totali	2.000.000		1.500.000	

Nr	Konto		PERSHKRIMI	SHUMA	
	+	-		D	K
1			K-to Objektet ndërtimore K-to Toka K-to Kërkesa nga TVSh e paguar K-to Detyrimet ndaj furnitorëve blerja e depos sipas faturës nr. 21	900.000 600.000 270.000	1.770.000

Mjetet	=	kapitali	+ detyrimet
900.000 + 600.000			1.500.000

Çka ndodh në bilancin e gjendjes?

Rritet një zë bilancor në aktivë (Objektet ndërtimore);

Zë tjetër bilancor po ashtu rritet në pasivë (Detyrime ndaj furnitorëve);

Shuma e bilancit rritet - si në aktivë ashtu edhe në pasivë.

7.4.7. Zëvendësimi i mjeteve të përdorura me mjete të reja

Si formë e furnizimit dhe largimit të mjeteve kryesore nga përdorimi, subjektet ekonomike e përdorin edhe zëvendësimin e mjeteve të përdorura me mjete të reja. Kjo formë e afarizmit dhe manipulimit me mjetet materiale, subjektet ekonomike, në praktikë e përdorin më së shpeshti tek automjetet, por gjen aplikim edhe tek mjetet tjera materiale afatgjata. Më së shpeshti, zëvendësimi i mjeteve materiale afatgjata nga subjekti ekonomik, trajtohet si shitje e mjeteve të vjetra kryesore dhe blerjen e mjeteve të reja kryesore. Evidentimi kontabël i zëvendësimit të mjeteve të vjetra me mjete të reja kryesore është i ngjajshëm me evidentimin kontabël të shitjes së mjeteve kryesore.

Shembull:

“Aida” Shpk ka një eskavator të vjetër vlera furnizuese (fillestare) e të cilit është 800.000 den. Me 30.12.2013 eskavatori e ka vlerën kontabël 100.000 den. “Motor-trade” Shpk na ofron mundësin e ndërimit të eskavatorit të vjetër me një të ri, vlera e tregut e të cilit është 900.000 den. “Motor-trade” i pranon “Aidës” shumën prej 150.000 den. për eskavatorin e vjetër, ndërsa “Aida” duhet të paguajë 750.000 den. për eskavatorin e ri. Kushtet e tilla janë pranuar nga të dy subjektet ekonomike.

Nr	Konto		PERSHKRIMI	SHUMA	
	+	-		D	K
1			K-to Mjetet transportuese (eskavatori i ri)	900.000	
			K-to Zhvlerësimi i akum.(eskavatori i vjetër)	700.000	
			K-to Mjetet transportuese(eskavatori i vjetër)		800.000
			K-to Xhirollogaria		750.000
			K-to Fitimi nga zëvendësimi i mjeteve		50.000
			Zëvendësimi i eskavatorit të vjetër me të ri		

Mjetet	=	Kapitali	+	detyrimet
+900.000		+700.000		+50.000
-800.000				- 750.000

7.5. Tjetërsimi i aktiveve afatgjata

Subjektet ekonomike mjetet e tyre kryesore (aktivet afatgjata) i nxjerrin jashtë përdorimit para skadimit të afatit të tyre të përdorimit, si pasojë e konsumit fizik apo moral. Tjetërsimi apo largimi i aktiveve afatgjata bëhet nëpërmjet shitjes, shlyerjes, dhënjes falas dhe ndërrimit me pasuri tjetër.

Gjatë tjetërsimit të mjeteve kryesore, duhet llogaritur dhe regjistruar zhvlerësimin e mjetit si dhe të llogaritet humbja ose fitimi nga nxjerrja apo tjetërsimi i mjeteve kryesore. Për mjetet themelore për të cilat është llogaritur dhe regjistruar amortizimi i tërësishëm, ndërsa subjekti vazhdon ta përdor edhe pas zhvlerësimit të tërësishëm, për këto mjete nuk duhet të llogaritet dhe regjistrohet zhvlerësim i tyre.

7.5.1. Shitja e aktiveve afatgjata

Subjektet ekonomike, mjetet e tyre kryesore (objektet, makinat pajimet, etj.), të cilat nuk i përdorin mund tua shesin blerësve juridik apo fizik. Tjetërsimi i mjeteve apo aktiveve, nëpërmjet shitjes, mund të lajmërohet me tri situata si në vijim:

1. shitja e mjeteve baras me vlerën kontabël;

2.shitja e mjeteve mbi vlerën kontabël; dhe

3.shitja e mjeteve nën vlerën kontabël.

Gjatë shitjes së tyre, për evidencën kontabël, duhet pasur parasyshë vlerën furnizuese dhe asaj të amortizuar. Në qoftë se mjetet kryesore shiten mbi vlerën kontabël, atëherë rezulton fitim nga shitja, ndërsa kur shitet nën vlerën kontabël rezulton humbje nga shitja.

Shembull: “Aida” Shpk për shkak të mos shfrytëzimit të deposë ka vendosur ta shesë. Të dhënat kontable për vlerën e deposë janë:

1. Vlera furnizuese	420.000
2. Korgjimi i vlerës	- 220.000
3. Vlera e tanishme	<u>200.000</u>

Depoja i është shitur blerësit “A.B.” me para të gatshmenë vlerë prej:

- a). 200.000,
- b). 220.000 dhe
- c). 180.000

	K-to		P Ë R S H K R I M I	SHUMA	
	D	K			
a			K-to Arka	200.000	
			K-to Zhvlerësimi i akumuluar i MK	220.000	
			K-to Objekti ndërtimor		420.000
			Shitja e objektit (depos)		
b			K-to Arka	220.000	
			K-to Zhvlerësimi i akumuluar i MK	220.000	
			K-to Objekti ndërtimor		420.000
			K-to Fitimi nga shitja e mjeteve kryesore		20.000
c			Shitja e depos mbi vlerën kontabël		
			K-to Arka	180.000	
			K-to Zhvlerësimi i akumuluar i MK	220.000	
			K-to Humbja nga shitja e mjeteve kryesore	20.000	
		K-to Objektet ndërtimore		420.000	
		Shitja e depos nën çmimin kushtues			

c). Mjetet	= Kapitali	+ detyrimet
180.000 + 220.000	-20.000	
-420.000		

Duhet theksuar se gjatë shitjes së mjeteve kryesore (aktiveve afatgjata) duhet të mbyllet apo shuhet kontot korigjuese, “zhvlerësimi i akumuluar i MK” dhe kontoja e mjeteve kryesore, në këtë rast kontoja “objektet ndërtimore-depoja”.

7.5.2. Shlyerja e mjeteve kryesore materiale

Në kushtet bashkohore të afarizmit, nën ndikimin e zhvillimit të shpejtë të teknikës dhe teknologjisë në procesin e prodhimit, rallë herë mjetet kryesore mbahen apo shfrytëzohen deri në datën e skadimit të përdorimit të tyre. Vlerësimi jo i drejtë i afatit të përdorimit, ndryshimet e shpejta në industri, janë disa nga faktorët të cilët ndikojnë në tjetërsimin apo largimin e mjeteve afatgjata përpara afatit të skadimit. Çdo largim i parakohshëm i mjeteve materiale para afatit të jetëgjatësisë, për subjektin ekonomik nënkupton humbje për pjesën e pazhvlerësuar.

Shembull:

Organi udhëheqës i “Besa” Shpk ka sjell vendim për shlyerjen e një makine. Në kontabilitet kjo makinë është evidentuar me një vlerë prej 75.000,00 den. ndërsa vlera e zhvlerësuar është 50.000,00 den.

k o n t o		P ë r s h k r i m i	s h u m a	
debi	kredi		d e b i	k r e d i
		K-to Zhvlerësimi i akumuluar i MK	50.000	
		K-to Humbje nga tjetërsimi i MK	25.000	
		K-to Makinat		75.000
		sipas vendimit për shlyerje të makinës		

Mjetet = Kapitali + Detyrimet
50.000 -25.000
-75.000

Kur bëjmë shlyerjen e MK kontimi bëhet në mënyrë që në anën debitore na lajmërohen kontot “zhvlerësimi i akumuluar i MK”, për pjesën e pazhvlerësuar të mjeteve kryesore po ashtu debiton kontoja “humbje nga tjetërsimi i MK”, ndërsa krediton kontoja “mjetet materiale”, respektivisht kontoja “makinat”.

+K-to Zhvler.i akumuluar -	+K-to Humbja nga shitja e MK-	+ K-to Makinat -
50.000	25.000	75.000

7.5.3. Dhënija falas e mjeteve kryesore

Kur një mjet kryesor, për arsye të ndryshme bëhet i panevojshëm për subjektin ekonomik, atëherë ai duhet të tjetërsohet. Njëra nga mënyrat e tjetërsimit të mjetit kryesor është dhurimi, pra dhënja falas pa asnjë kompensim ndonjë subjekti tjetër.

Shembull.

Organi udhëheqës i Shpk “Besa” ka vendosur që Shpk “Luli trade” t’i japë falas një mjet transportues. Vlera furnizuese e mjetit transportues është 40.000 den., korrigjimi i vlerës është 30.000. Kontrata është realizuar.

Kontimi:

1. K-to Zhvlerësimi i akumuluar i MK.	30.000	
K-to Humbja nga shitja e MK	10.000	
K-to Mjetet transportuese		40.000
dhënia falas e mjetit transportues		

Mjetet	=	Kapitali	+	Detyrimet
30.000		-10.000		
-40.000				

PYETJE:

1. Çfarë paraqesin aktivet afatgjata? Si klasifikohen ato?
2. Në cilat dokumente kontabël mbahet evidenca e aktiveve afatgjata?
3. Cilat janë karakteristikat themelore të aktiveve afatgjata?
4. Cilët janë karakteristikat e mjeteve jomateriale?
5. Çfarë janë mjetet e paprekshme (jomateriale) dhe si klasifikohen ato?
6. Çfarë është patenta dhe çfarë është licenca?
7. Cilat të dhëna duhet t'i sigurojë kontabiliteti financiar i aktiveve afatgjata?
8. Në cilat mënyra mund të furnizohen AAGJ?
9. Cilat janë format e tjetërsimit të mjeteve kryesore (AAGJ)?
10. Çfarë përfshin vlera furnizuese e AAGJ?
11. Ku qëndron dallimi në mes tokës dhe mjeteve tjera afatgjata?
12. Zërat bilancor të mjeteve kryesore (aktiveve afatgjat) të karkaterizohen në aktive materiale dhe jomateriale (sheno M- për materiale dhe Jo – për jomateriale).

shenja	Zëri bilancor	shenja	Zëri bilancor
	Goodwilli		Objektet ndërtimore
	Pajimet		Markat tregtare
	Maqineritë		Patentat
	Toka		Invest.financioare afagjata
	Licenca		Të mbjerutat shumëvjecare

13. “Besniku” Shpk nga Tetova ka blerë tokë për ndërtimin e një objekti industrial me këto vlera:

- Cmimi tokës së blerë 950.000 denarë.
- Shpenzimet reth bartjes së pronësisë 15.000 denarë.
- Shpenzimet për prishjen e objektit ekzistues 20.000 denarë
- Shërbimet e provizionit për patundshmërinë 27.000 denarë

“Besniku” Shpk nuk është obligues tatimor dhe pagesën e bërë nga xhirollogaria.

14. “Blerta” Shpk nga Struga ka blerë një objekt ndërtimorë (shitore) me këto vlera:

- Çmimi i shitores 1.140.000 d.
- Shpenzimet për bartjen e pronësisë 45.000 d.
- Shpenzimet e interesit (kamatës) 15.000 d.

-Provizioni për patundshmërinë 30.000 d.

“Blerta” Shpk nuk është obligues tatimor dhe pagesa për çmimin e shitores dhe shpenzimeve për bartje janë bërë nga xhirollogaria, ndërsa shpenzimet e interesit dhe provizioni për patundshmërinë janë paguar nga arka në kesh.

15. “Antigona” Shpk, sipas faturës nr. 24 të datës 06.05.20__ ka blerë një mjet transportues në vlerë prej 65.000d. dhe Tvsh në vlerë prej 11.700d. nga furnitori “Agoni” Shpk. Për shpenzimet e ndërmjetsimit, notarizimit, sigurimit nga furnitori “Teuta” Shpk kemi pranuar faturën nr.123 në vlerë prej 23600 den. (20.000 + 3600 TVSH).

Të tre subjektet ekonomike janë obligues tatimor. Mjeti transportues është dhënë në përdorim.

16. “Lulja” Shpk nga Ohri me datë 29 Mars 2014 me faturë nr.23 ka shitur një mjet transportues në vlerë prej 220.000 denarë.

Mjeti transportues është blerë para 5 vitesh (13.12.2009) në vlerë prej 600.000 denarësh.

Mjeti transportues shkallën e amortizimit e ka 10%.

$(600.000 \times 10\% = 60.000 / 12 = 5.000 \times 3 = 15.000$ – amortizimi për vitin 2014.

$(5 \times 60.000 = 300.000 + 15.000 = 315.000$ amortizimi i akumuluar.

Të llogaritet amortizimi për vitin 2014, për vitet paraprake dhe të llogaritet fitimi nga shitja dhe të bëhen regjistrimet e nevojshme kontabël në ditar.

17. “Genti” Shpk nga Resnja këmben një makinë të vjetër, me vlerën furnizuese prej 300.000 denarësh dhe amortizim të akumuluar prej 120.000 denarësh, për një motor të ri nga ku paguan edhe 30.000 denarë. Çmimi i tregut të makinës së vjetër është 150.000 denarë.

(motori = $150.000 + 30.000 = 180.000$; amort.i akumuluar=120.000; Humbja nga shitja 30.000).